



Turgut Özal

BULETIN



PËRMBAJTJA

1. Në Parlament
2. Në Kuvendin e Shqipërisë
3. Në Kryesinë e Kuvendit
4. Vizitë në Kryeministri
5. Në Ministrinë e Inovacionit
6. Në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
7. ASEF
8. ASEF vizitohet nga Ilir Meta
9. Në ceremoni e pranishme Znj. Milena Harito
10. CLIL – mësimdhënia e suksesshme
11. Olimpiada Shkencore Epoka
12. Certifikata nga Univeristeti i Uoterlusë
13. Noetic Learning
14. Përfundimet e Olimpiadës së Matematikës
15. Olimpiada e Gjuhës Angleze Kangaroo
16. Festivali i 21-të i kërcimit
17. E drejta e autorit
18. GDS 2
19. Bisedë me psikologun
21. Dita e Verës
22. Java e Matematikës
23. English Week – globi brenda shkollës
24. E diela shqiptare viziton shkollën
25. Të mbjellim pemë
26. Bashkë me Fundjava Ndryshe
27. Në Tangram

Klubi i Medias:
Mësues
Erjon Saliasi
Erjona Saqe
Imelda Preçe
Elda Rrustemi

Nxënës
Engjëllushe Basha
Enisa Dalipi
Breana Shehetila
Gea Ivanaj
Vivien Shkodra
Xhoia Mekollari

Fotograf
Lulëzim Marra

Dizajn:
Dorjan Pitani

ADRESA
Rruga "Bernardin Palja"
Ndërtesa 15, Hyrja 1
Njësia Bashkiake Nr.6
Tiranë – Shqipëri

TEL: +355 42 486-666
FAX: +355 42 486-666
info@turgutozal.edu.al

TURGUT ÖZAL

19

TIRANË

AL COLLEGE

95

ANË

28. Klubi i Robotikës
29. Klubi i ëmbël
30. Shëtitje dimërore
31. Shëtitje nëpër Evropë
32. Vizitë në Muzeun Historik Kombëtar
33. Në MIST – International Fair
34. Vizitë në Bunkart
35. Shëtitje në Dajt
36. Vizitë në Bashkinë e Tiranës dhe Kullën e Sahatit
37. Ekskursion në Durrës
38. Vizitojmë biznese
39. Në Cineplex
40. Vizitë në News24
41. Festa e Abetares
42. 8 Marsi
43. Festë vetëm për mësuesit
44. Kampionati i Hendbollit
45. Finalet e basketbollit
46. Ndeshja e futbollit me shkollën MIST
47. Kampionati i futbollit
48. Kampionati i futbollit – klasat 4, 5
49. Kampionati i basketbollit – klasat 4, 5
50. Dita e Balonave
51. Shëtitje në Kopshtin Botanik
52. Mbjellja e luleve dhe kujdesi për to
53. Në pulari
54. Përgatitim gurabije
55. Shëtitje te Kopshti Zoologjik
56. 8 Marsi në kopsht
57. Këshilla nga prindërit
58. Në cirk



NË PARLAMENT

Nxënësit e klasës së 6-të G, bënë një vizitë në Kuvendin e Shqipërisë, ku u pritën nga z.Illir Meta, Kryetar i Parlamentit, dhe nga përfaqësues të tjerë të Kuvendit.

Fillimisht fëmijët zunë vendet në sallë dhe më pas u njohën me procedurat e zhvillimit të një seance parlamentare, në të cilën ata vetë ishin "protagonistët" ose përfaqësues të Kuvendit - pjesë e së cilës qe edhe vetë z.Meta

Pas seancës nxënësit u ftuan të merrnin pjesë në një bisedë të këndshme dhe të lirshme rreth mbarëvajtjes në mësim.

Falenderimet e dyanshme ishin ato që mbyllën këtë vizitë mbresëlënëse.

NË KUVENDIN E SHQIPËRISË

Me ftesë të kryeparlamentarit, z.Illir Meta, nxënësit e klasave të gjashta vizituan Kuvendin e Shqipërisë.

Gjithçka u organizua në formën e një seance parlamentare. Për nxënësit ishte bukur të viheshin në rolin e kryeministrit, të kryetarit të Kuvendit dhe të ministrave apo deputetëve. Nxënësit propozuan ligjin për mjedisin dhe hodhën ide të reja për shtimin e hapësirave të gjelbra, parandalimin e ndotjes së tepërt në mjedis dhe riciklimin.

Në mbyllje të kësaj seance të veçantë, z.Meta i komplimentoi nxënësit dhe vlerësoi pozitivisht mendimet e tyre inovative.



NË KRYESINË E KUVENDIT

Nxënësit e klasës së parë vizituan Kryesinë e Kuvendit të Shqipërisë, ku u mirëpritën nga znj.Valentina Leskaj, nënkryetare e Kuvendit të Shqipërisë.

Biseda e këndshme që u zhvillua kishte si temë emocionet e veçanta që falin festat e muajit mars.

Zonja Leskaj u uroi shumë suksese këtyre vogëlushëve që sapo kanë nisur udhëtimin në rrugën e dijes dhe tha se do të ishte kënaqësi nëse këta fëmijë do ta vizitonin sërish, por kësaj radhe me dëshirën dhe kureshtjen për të parë nga afër se si zhvillohet një seancë parlamentare.





VIZITË NË KRYEMINISTRI

Përfaqësues të klasave të katërta dhe të pesta bënë një vizitë në Kryeministri, ku me rastin e 8 Marsit uruan Ministren për Marrëdhëniet me Parlamentin, Znj. Ermonela Felaj, si një nënë, grua dhe femër në karrierë. Pas prezantimit dhe urimeve, nxënësit, të shoqëruar nga Ministria, shkuan në katin e parë të kryeministrit për të vizituar qendrën për Hapje dhe Dialog (COD). Aty panë një bibliotekë mjaft interesante në të cilën janë arshivuar të gjitha vendimet e Këshillit të Ministrave që nga viti 1945 e në vazhdim. Më pas, fëmijët patën rastin të shihnin nga afër çdo ambient të kësaj godine.

NË MINISTRINË E INOVACIONIT

Nxënësit e klasës 8G, më datën 8 Mars, zhvilluan një takim mjaft interesant me Ministren e Inovacionit, zonjën Milena Harito, në ambientet e kësaj ministrie. Nxënësve iu tregua për mundësitë që ata kanë për të shfrytëzuar hapësirat e Innovation Hub, apo për t'u bërë pjesë e projekteve të tjera që po zhvillon kjo ministri për të mbështetur idetë e të rinjve të talentuar. Gjithashtu nxënësit e ftuan Znj. Milena Harito në Finalen e ASEF-it.



NË MINISTRINË E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË

Takim ndryshe, e ka quajtur Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Z. Blendi Klosi, takimin me nxënësit e klasës 8A, zhvilluar në ambientet e kësaj ministrie.

Në një bashkëbisedim të sinqertë me ta Z. Klosi u shpjegoi nxënësve se çfarë çështjesh mbulon kjo ministri dhe politikat sociale që ajo ndjek. Më pas Ministri iu përgjigj disa pyetjeve të nxënësve, duke sqaruar dhe një nismë për një projektligj mbi të drejtat e fëmijëve.

Ndërsa klasa 8G më herët ishte pritur nga Zëvendësministria, Znj. Bardhylka Kospiri, e cila i njohu me një sërë nismash dhe reformat e ndërmarra nga kjo ministri, ligjet e propozuara dhe me shpenzimet e ndryshme të kryera në ndihmë të komunitetit.



ASEF

U zhvillua panairi shkencor ASEF, për kategoritë senior dhe junior me rreth 500 projekte nga nxënësit e shkollave Mehmet Akif (vajza/djem), MIST, Turgut Özal (Tiranë), Turgut Özal (Durrës) dhe Hasan Riza Pasha (Shkodër) u zhvillua në dy fundjava të ndryshme.

Projektet përfshinin fushën e teknologjisë së informacionit dhe shkencës, si: natural sciences, social sciences, poster design, industrial design, programming dhe short movie.

Juria kishte në përbërjen e saj mësues dhe profesorë nga shkolla e universitete të vendeve të ndryshme të rajonit si: Maqedonia, Mali i Zi, Kosova, Shqipëria etj.

Gjykimi i jurisë zgjati rreth gjashtë orë dhe në përfundim të tij projektet më të mira u shpërblyen me medalje, ndërsa nga kategoria senior dy projektet të vlerësuara me më shumë pikë nga të gjithë anëtarët e jurisë do të përfaqësojnë Shqipërinë në SHBA në konkursin e projekteve ISWEEEP.

ASEF VIZITOHET NGA Z. ILIR META

“Është kënaqësi që marr pjesë në këtë ngjarje të veçantë,” u shpreh në ceremoninë e hapjes së ASEF 2017 Z. Ilir Meta, Kryetari i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

“E ardhmja kërkon dije dhe ju sot po tregoni se jeni të vendosur për të ecuar në këtë rrugë që e çon para vendin,” u shpreh në fjalën e tij Z. Meta duke inkurajuar nxënësit e shkollave 9-vjeçare “Turgut Özal” në Tiranë dhe Durrës, MIST, “Hasan Riza Pasha”, pjesëmarrësit e tjerë, prindërit e nxënësve dhe stafin drejtues.

Më pas, teksa juria e ASEF nisi vlerësimin e projekteve, Z. Meta vizitoi standat dhe bashkëbisedoi me nxënësit.



NË CEREMONI E PRANISHME ZNJ. MILENA HARITO



Panairi i projekteve ASEF 2017 u mbyll me ceremoninë e shpërndarjes së çmimeve, ku prezente ishte Znj. Milena Harito, Ministre për Inovacionin dhe Administratën Publike. Në fjalën e saj përshëndetëse Znj. Harito, duke theksuar se tashmë Institucionet Arsimore “Turgut Özal” kanë shumë eksperiencë në organizimin e këtyre panairove, sugjeroi se në këtë eveniment në vitet e ardhshme të ftohen edhe shkollat e tjera për të ndarë eksperiencën dhe për t’u mësuar se si të organizojnë këto panairore kaq të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të nxënësve. Më pas Znj. Harito shpërndau medaljet e arta për nxënësit fitues të vendeve të para.

CLIL - MËSIMDHËNIA E SUKSESSHME

Content and Language Integrated Learning (CLIL) zhvilloi me sukses konferencën e saj të parë në ambientet e shkollës "Turgut Özal", Tiranë. Ishin mbi 450 pjesëmarrës në këtë konferencë, të cilët ndoqën 2 seanca plenare, 6 seanca të njëkohshme dhe 46 prezantime poster në lidhje me mësimdhënien e lëndëve shkencore në gjuhën angleze. Përveç tyre ishin edhe 4 sesione publicitare nga Cambridge University Press, Oxford University Press si dhe përfaqësues nga Houghton Mifflin Harcourt. Pjesëmarrësit në këtë konferencë ishin trajnerë profesionalë të mësuesve, mësues, edukatorë, zyrtarë, qeveritarë, përfaqësues të shtëpive botuese, administratorë të arsimit etj. Vendet nga të cilat vinin folësit kyç dhe pjesëmarrësit e tjerë përfshinin jo vetëm vendet e rajonit si: Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Bosnje-Hercegovina e Serbia, por edhe shumë vende të tjera, si: SHBA, Britania e Madhe, Kanadaja, Irlanda, Hungaria, Spanja e Turqia.



OLIMPIADA E GJUHËS ANGLEZE KANGAROO



Këtë vit, për herë të parë u organizua në Shqipëri Olimpiada e Gjuhës Angleze - Kangaroo Global Linguistic (KGL). Ky konkurs ndërkombëtar, i cili zhvillohet një herë në vit dhe është i hapur për të gjithë nxënësit nga klasa e 3të deri në klasën e 12të (8-18 vjeç), kalon në tre faza. Faza e parë u zhvillua në 20 maj. Në të morën pjesë një numër i konsiderueshëm nxënësish nga shkolla jonë, duke filluar që nga klasa e tretë e ciklit fillor e deri te klasat e nënta. Faza e dytë do të zhvillohet në 3 qershor përsëri në Tiranë, ndërsa faza finale në 15 shtator në Greqi.

CERTIFIKATA NGA UNIVERSITETI I UOTERLUSË



Dhjetë nxënës të shkollës sonë u vlerësuan me certifikatë nderi në provimin e matematikës të organizuar nga Universiteti i Uoterlusë.

Provimi u organizua në datën 1 mars në kompleksin “Turgut Özal”, duke qenë se shkolla jonë është qendër e autorizuar për këtë provim.

Ky provim organizohet për të frymëzuar nxënësit dhe rritur dashurinë e tyre ndaj matematikës. Nxënësit pjesëmarrës ishin: Heidi Durrësi, Eraldi Nela, David Selba, Enrik Sina, Bjorna Permeti, Jera Isakaj, Mirela Kafazi, Artela Roshi, Olsi Canaj, Ajdi Hasekiu.

NOETIC LEARNING

Përveç provimeve të organizuara nga mësuesit e klasës apo drejtoria e shkollës, nxënësit e klasave të katërta dhe të pesta të shkollës sonë kanë marrë pjesë me dëshirë në një provim ndërkombëtar, Noetic Learning, për lëndën e Matematikës. Qëllimi kryesor ishte të provonin veten krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre kudo në botë madje edhe në vendet më të zhvilluara të Evropës, dhe pse jo të hynin në nxënësit më të mirë në botë emrat e të cilëve kjo faqe i publikon në Google, duke i bërë të njohur ndërkombëtarisht. Nxënësit të cilët morën pjesë në këtë test u pajisën me certifikata nga kjo qendër ndërkombëtare.



PËRFUNDIMET E OLIMPIADËS SË MATEMATIKËS, FAZA E REPUBLIKËS



Heidi Durrësi



Ingis Beliu



David Selba

Olimpiada Kombëtare e Matematikës përmbylli me sukses fazën e saj finale (të tretë). Nxënësit e shkollës sonë u përfaqësuan shumë denjësisht duke fituar dy vendet e para dhe një vend të tretë.

Vendet e para u fituan nga nxënëset Ingis Beliu dhe Heidi Durrësi, kurse vendi i tretë u fitua nga nxënësi David Selba.

OLIMPIADA SHKENCORE EPOKA

Me një pjesëmarrje të gjerë është zhvilluar edhe këtë vit olimpiada shkencore e universitet EPOKA në bashkëpunim me kolegjin "Turgut Özal".

Në këtë olimpiadë marrin pjesë nxënës nga klasat 6 deri në 11 nga shkollat "Turgut Özal", "Mehmet Akif", "Hasan Riza Pasha" dhe MIST.

Nxënësit pjesëmarrës janë përgatitur nga mësuesit e tyre thuajse prej fillimit të vitit në lëndët shkencore si dhe në informatikë dhe gjuhë angleze. Më të mirët e secilës kategori u shpërblyen me medalje.



E DREJTA E AUTORIT

Në shkollën tonë, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, u zhvillua konkursi i pikturës dhe posterit me mesazh të caktuar për Ditën Botërore të Pronësisë Intellektuale. Slogani i aktivitetit ishte: "Duke krijuar zbukurojmë jetët tona. Bëhu dhe ti artist!"

Morën pjesë nxënës nga klasat 7-9 që treguan perceptimin e tyre mbi mbrojtjen e autorit dhe krijimit të tij.

Për krijimet më të mira u shpërndanë certifikata dhe u dhanë dhurata.





GDS 2

Periudha prill-maj përkon me zhvillimin e GDS-ve (testet me alternativa në të gjitha lëndët) për periudhën e dytë të vitit shkollor. Me anën e këtyre testeve, drejtoria e shkollës dhe mësuesit matin njohuritë e marra nga nxënësit për periudhën janar-prill. Duke e zhvilluar testin online nxënësit njihen me rezultatin në kohë reale, korrigjimi bëhet në mënyrë objektive dhe, njëkohësisht, mësuesit marrin një statistikë të shpejtë dhe të plotë për të gjitha përgjigjet e dhëna. Të gjithë nxënësit, përpara se të zhvillojnë testin, futen nga adresat e tyre personale në sistemin online të shkollës për të zhvilluar teste përgatitore apo webquize përsëritëse.



BISEDË ME PSIKOLOGEN

Klasat e teta morën pjesë në një seminar të zhvilluar nën drejtimin e psikologes së shkollës, ku u trajtua tema e imazhit dhe u fol për rëndësinë e tij.

Psikologja shpjegoi se pse adoleshentët identifikohen me imazhin e tyre dhe vlerën që ka ai në stimulimin e tyre të brendshëm.

Gjatë bisedës u transmetua te nxënësit rëndësia e gërshetimit të duhur që i duhet bërë pamjes së jashtme dhe zhvillimit të brendshëm njohës e emocional.

DITA E VERËS

Shkolla jonë mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Bashkia e Tiranës, me rastin e Ditës së Verës. Programi i nxënësve tanë që u paraqit para publikut të shumtë të asaj dite, konsistonte në ekspozimin e standës me punimet më të mira të klubit të robotikës dhe aktivitetin artistik të përfaqësuar nga grupi i folklorit të shkollës.

Vajzat dhe djemtë e këtij grupi performuan mjeshtërisht përmes një kërcimi modern dhe një valleje popullore. Prezantimi ishte mjaft estetik, me veshjet dhe aksesorët tradicionalë që kishin zbukuruar nxënësit tanë në atë ditë festive.



FESTIVALI I 21-TË I KËRCIMIT

Në ambientet e shkollës sonë krahas shumë aktiviteteve të tjera, këtë vit në bashkëpunim me Albania Gymnaestrada, u organizua edhe Festivali i 21^{të} i kërcimit. Në këtë aktivitet morën pjesë grupe të shumta kërcimi nga të gjitha trevat shqiptare. Ritmet e shpejta, veshjet e larmishme, kërcimet e shumëllojshme i dhanë jetë dhe gjallëri skenës së Pallatit të Koncerteve të shkollës sonë. Në përfundim u ndanë certifikata për të gjithë pjesëmarrësit, si dhe medalje dhe kupa për grupet me performancën më të mirë. Me çmim të parë u vlerësuan tre grupe kërcimi, midis tyre edhe trupa e kërcimit të shkollës sonë.





JAVA E MATEMATIKËS

Java e Matematikës, e cila këtë vit mori përmasa të veçanta, sërish solli një sërë aktivitesh dhe lojërash matematikore dhe logjike. Gjatë saj u zhvilluan lojërat si Sudoku, Jenga dhe IQ test si dhe konkurse e prezantime të ndryshme.

Njohuritë dhe kuriozitetet e ndryshme në lëndën e matematikës, nxënësit i kanë paraqitur dhe nëpërmjet posterave, trupave gjeometrikë, miniatura ndërtesash të njohura të bëra prej tyre, konkursi dizajn dhe projekt 3D, si dhe bluzave me thënie të ndryshme për lëndën e matematikës.

Një risi për Javën e Matematikës ishte konkursi i pikturës me temë "Matematika". Në këtë konkurs, nxënësit imagjinatën e tyre e kanë shfaqur të kombinuar me njohuritë në matematikë, duke krijuar piktura shumë të veçanta.

ENGLISH WEEK - GLOBI BRENDË SHKOLLËS

Fundi i muajit mars shënoi dhe përfundimin e Javës së Anglishtes, e cila solli si gjithmonë emocione të veçanta në shkollë. Gjatë kësaj jave u zhvilluan disa konkurse në fusha të ndryshme, por me një të përbashkët, gjuhën angleze, ku u theksua respekti dhe toleranca ndaj kulturave dhe traditave të të gjitha vendeve nëpër botë. Disa nga konkurset e zhvilluara janë:

Song Contest, Poetry Contest, Dictionary Contest, Culture Corner etj.

Të ftuar të ndryshëm vizituan disa klasa-shtete si: 4G (Portugali) - u vizitua nga Konsull Nderi Shqiptar për Portugalinë; 4F (Itali) - nga Drejtoresha e Institutit Italian të Kulturës dhe Përgjegjësja Administrative e po këtij institucioni; 4D (Egjipt) - nga Znj. Anila Basha, gazetare e NewsBomb; 5G (Francë) - nga Isabelle Jouan, e cila jeton prej 8 vitesh në Tiranë etj.

Në përfundim të konkursit u dha një shfaqje me këngët dhe poezitë fituese të vendeve të para si dhe u ndanë certifikata për të gjithë fituesit.



NË MUZEUN ARKEOLOGJIK



Nxënësit e klasës 3A të ftuar nga dy prindër arkeologë, Rovenë dhe Rudenc Ruka, bënë një vizitë në Muzeun Arkeologjik Kombëtar. Ky muze është qendra ku pasqyrohet pjesa më e madhe e pasurisë arkeologjike në vend. Gjatë kësaj vizite nxënësit panë me kureshti veglat me të cilat punonin njerëzit dikur, stolitë e tyre të zbukurimit, enët prej balte dhe plot objekte të gjendura në vendin tonë, që u takojnë periudhave të ndryshme historike.

“E DIELA SHQIPTARE” VIZITON SHKOLLËN

“Çfarë metodash duhet të ndjekim në ushqyerjen e fëmijëve dhe cilat ushqime duhet të jenë në menunë e tyre?”, ishte pyetja për të cilën na informoi dietologja Blerina Bombaj, në vizitën që bëri në shkollën tonë. Së bashku me producentin Ardit Gjebrea, ajo realizoi rubrikën e saj “Ne jemi çfarë hamë” në një rrëzë nga mensat e shkollës dhe misioni i radhës ishte: “Të mësojmë fëmijët të ushqehen shëndetshëm”. Këshillat e saj kishin të bënin me larmishmërinë e ushqimeve që duhet të ketë tryeza e shtëpisë sonë dhe mënyrën se si duhet t’i bindim fëmijët të hanë sa më shumë gjellë me perime e sa më pak ushqime të thata e të shpejta. Pjesa më interesante e rubrikës ishte prova me nxënësit, e cila kishte si objektiv të zbulonte sa i hanë ata perimet



TË MBJELLIM PEMË

Nxënësit e klasave të pesta u bënë pjesë e projektit bashkiak për mbjelljen e 1 mijë pemëve në muaj.

Me dëshirën për të qenë sa më afër natyrës, ata ndihmuan punëtorët e gjelbërimit në hedhjen dhe rregullimin e dheut tek pemët e sapovendosura në një nga rrugët e Laprakës.

Ky aktivitet u shërbeu fëmijëve që të ndërgjegjësohen për rëndësinë që ka kujdesi i secilit prej nesh në ruajtjen e mjedisit dhe mbjelljen e pemëve, të cilat ndikojnë pozitivisht në zhdukjen e gazrave të dëmshme të atmosferës.



BASHKË ME “FUNDJAVA NDRYSHE”

Nxënësit e klasës 7F iu bashkuan në një ndërmarrje bamirësie nismës “Fundjavë Ndryshe” duke mbledhur veshje e lodra dhe kontribuan me një shumë parash, me të cilat blenë ushqimet bazë për një familje në nevojë. Familja u zgjodh nga stafi i Fundjavës Ndryshe, të cilët dhe i shoqëruan nxënësit. Familja, e cila u ndihmua, jetonte në shtëpi me qera, kishte vetëm një ndihmë minimale ekonomike dhe përbëhej nga 4 anëtarë, babai i sëmurë, nëna dhe dy fëmijë (3 vjeç, 5 vjeç).



NË TANGRAM

Iniciativat e nxënësve të shkollës sonë, idetë e tyre inovative për të pasur një Shqipëri më të mirë vazhdojnë të prezantohen në emisionin e njohur për fëmijë, "Tangram". Në këtë periudhë ishin gjashtë projekte që u shfaqën nga nxënësit tanë.

Marin Shpata, 8F, me projektin "Shqipëria më e mirë duke zhvilluar shkencën e robotëve". Ai prezantoi punën që bëhet në Klubin e Robotikës të shkollës dhe idetë e tij për të ardhmen e kësaj shkençe.



Colin Balla, 5F, me projektin "Shqipëria më e mirë kur ne të ndihmojmë ata që kanë më shumë nevojë". Për të ai bashkëpunoi me nxënësit e Klubit Shpresa dhe mbledhën 100 pako ushqime për shoqatën e Jetimëve.

Kristel Serra, 5G, me projektin "Shqipëria më e mirë kur ne gatujmë dhe ushqehemi shëndetshëm". Për të ajo bashkëpunoi me Klubin e Gatimit të shkollës.



Amir Gjana, 5F, prezantoi projektin në formë videoje me temë "Shqipëria më e mirë kur ne të respektojmë vajzat".



Ema Çausaj, 5G, me projektin "Shqipëria më e mirë kur ne dhurojmë lodra". Për realizimin e tij ajo bëri një fushatë për mbledhje lodrash për vogëlushët e kopshtit "Sauk i Vjetër".

Valenci Shehaj, 3C, me projektin "Shqipëria më e mirë kur ne të kursejmë". Për të ai solli në kujtesë të teleshikuesve se nuk duhet të shpërdorojmë, por të riciklojmë dhe ripërdorim sa më shumë.




KLUBI I ROBOTIKËS

Nxënësit e klubit të robotikës kanë punuar për ndërtimin e një tanku me lego, projektimin e një qeni dhe gjithashtu të disa pajisjeve bioloid.

Grupi i klasave të 8-ta ka përfunduar me sukses ndërtimin e një roboti-njeri të quajtur Humanoid, i cili është i aftë të ecë dhe të bëjë ushtrime fizike, projekt me të cilin shkolla jonë u përfaqësua në emisionin "Tangram". Grupi i klasave të gjashta konkuroi në konkursin ndërkombëtar "Infomatrix", i cili organizohet në Rumani, ku nxënësit Dardi Peka dhe Ballëm Gega morën medalje argjendi, ndërsa Mei Et'hemaj dhe Aurel Domi medalje bronzi.

Grupi i klasave të katërta e të pesta kanë përfunduar programimin e një roboti mBot ndërsa grupi i klasave të gjashta ka ndërtuar një robot të tipit Line Follower, me të cilin u pritët të prezantohen po në "Infomatrix".



KLUBI I ËMBËL

Ai mund të quhet ndryshe dhe "Klubi i ëmbël". Është fjala për Klubin e Gatimit në shkollën tonë, i cili për çdo ditë të hënë dhe të mërkurë mbledhet së bashku me mësueset drejtuese në kuzhinën e tyre të ngrohtë dhe, me pasionin që i karakterizon, përgatitin recetat e tyre "magjike" dhe shpërndajnë ëmbëlsi në gjithë shkollën.

Ballokumet e Ditës së Verës, zupat, krepat, sufle, kanë qenë këtë vit pjesë e kësaj ëmbëlsie.

Jo rrallë, pjesë e këtij klubi janë bërë dhe drejtues të shkollës, duke ndarë përvojat e tyre në fushën e kulinarisë.









SHËTITJE DIMËRORE

Shëtitjet dimërore këtë vit u zhvilluan në Maqedoni, Kosovë dhe Bosnje-Hercegovinë. Nxënësit e klasave të 4-ta dhe të 5-ta, si dhe vajzat dhe djemtë e klasave të 6-ta, të 7-ta dhe të 8-ta, vizituan Maqedoninë. Ndalesa e tyre e parë ishte në qytetin e Strugës, me një shëtitje në qytet dhe pastaj darka. Të nesërmen u nisën drejt Tetovës. Mëngjesi i ditës së dytë i gjeti nxënësit duke u argëtuar në pistën e skive me slitat e borës.

Udhëtimi vazhdoi me drekën në Tetovë dhe më pas rrugëtimin drejt Shkupit, ku sheshi me statujat e tij u bënë objekti kryesor i fotove të nxënësve. Darka në një qendër tregtare e më pas pishina dhe aktivitete të tjera përmbyllën ditën e fundit të shëtitjes. Ndërsa djemtë e klasave të 7-ta, të 8-ta dhe të 9-ta, e shijuan dëborën në pistën e skive të Sarajevës. Vizitat e ndryshme në qytet dhe në urën e famshme të Mostarit i njohën ata me historinë e këtij qyteti. Dita e fundit ishte mikpritja nga qyteti i bukur i Prizrenit.

SHËTITJE NËPËR EVROPË

Udhëtimi i këtij viti në Evropë kaloi nëpër shtetet Francë, Belgjikë dhe Hollandë. I shtrirë në pesë ditë, ky udhëtim ofroi vizita në muze, shëtitje nëpër pika të njohura turistike, lojëra në pishina, dije të reja dhe shumë argëtim.

Nxënësit pjesëmarrës do të mbajnë gjithnjë me vete përshtypje të paharrueshme nga Kulla Eifel, Katedralja e Notre Damit, bulevardi Champs-Élysées, Disney Land, në Paris. Po aq mbresëlënëse ishte edhe Brukseli, ku nxënësit panë muzeun e shkencës Pass, Grand Place-in dhe Atomium-in. Dhe në fund, Holanda i mahniti fëmijët me CORPUS-in, me fshatin turistik Wind Mills dhe shëtitjen me varkë nëpër qytetin e mrekullueshëm të Amsterdemit.



VIZITË NË MUZEUN HISTORIK KOMBËTAR

Nxënësit e klasës së 8D vizituan Muzeun Historik Kombëtar. Ata vizituan të gjitha pavionet e muzeut që nga Periudha Parahistorike, Antikiteti, Mesjeta e deri në Periudhën e Rilindjes Kombëtare, Shpalljes së Pavarësisë dhe vendosjes së Regjimit Komunist në Shqipëri. Nxënësit u njohën më nga afër me mënyrën e jetesës së popullit tonë ndër shekuj, veglat e punës, veshjet e ndryshme, traditat, ritet e zakonet dhe patën mundësi të shihnin nga afër ndikimet e kulturave të popujve të tjerë në kulturën tonë, kjo e pasqyruar në skulptura, mozaikë, arte murale etj. Gjithashtu u prezantuan me mënyrat e ndryshme të qeverisjes dhe organizimit të shtetit, që nga Periudha e Mesjetës e deri në shekullin e 20-të dhe rolin e personaliteteve e figurave të politikës dhe kulturës në këtë qeverisje.



NË MIST - INTERNATIONAL FAIR

Një ditë mjaft e veçantë ishte ajo që kaluan nxënësit e klasave të pesta të shkollës sonë kur vizituan ambientet e shkollës MIST. Kjo vizitë mbarti me vete plot surpriza të bukura, të cilat u ofruan prej Panairit Ndërkombëtar (International Fair) që organizohej nga nxënësit, prindërit dhe mësuesit e shkollës MIST. Stendat e panairit ishin krejtësisht të ndryshme nga njëra-tjetra pasi secila prej tyre përfaqësonte një shtet të botës. Çdo stendë kishte flamurin e vendit që përfaqësonte, gatimet e tij tradicionale, sende zbukurimi të punuara nga vetë nxënësit dhe veshjet popullore karakteristike të atij vendi. Gjithashtu, në ambientet e jashtme të shkollës ishte ngritur një skenë verore ku nxënësit këndonin apo kërcenin vallet tradicionale sipas vendeve që përfaqësonin.



Klinika Dentare "Toti & Gurakuqi"



Klinika Dentare "Toti & Gurakuqi" është e para klinikë dentare private e licensuar në Shqipëri që prej vitit 1992 nga themeluesi i saj Prof. Dr. Foto Toti. Vit pas viti, klinika u rrit dhe u modernizua për të ardhur në ditët e sotme akoma më e plotësuar si në staf, ashtu edhe në shërbime.

Numri i pacientëve të trajtuar pranë këtij institucioni shëndetësor është me mijëra dhe i kalon kufijtë e Shqipërisë.

"Të kesh një buzëqeshje rrezatuese me dhëmbë të shëndetshëm dhe të bukur është një investim për të ardhmen tuaj!"

Shërbimet që ofrohen pranë klinikës Toti & Gurakuqi:

Kirurgji Orale	Pedodonti
Implantologji	Terapi
Ortodonci	Dentistri Estetike
Protezim dentar	

Këto shërbime ofrohen si për fëmijët e vegjël edhe për adultet.

Shoqata Amerikane e Ortodontëve rekomandon se vlerësimi fillestar ortodontik duhet të bëhet me shfaqjen e shenjës së parë të problemeve ortodontike, ose jo më vonë se moshë 7 vjeç.



www.toti-gurakuqi.com

cel: +355 69 60 21 738

fix: +355 4 22 58 428

"Toti & Gurakuqi" Eksperencë, Profesionalizëm, Besueshmëri

VIZITË NË BASHKINË E TIRANËS DHE KULLËN E SAHATIT

Një aktivitet me shumë vlera, i cili synonte edukimin dhe njohjen me monumentet kulturore të qytetit tonë, ishte aktiviteti i nxënësve të klasës së 8E, i organizuar nën kujdesin e Kryetarit të Qarkut Tiranë, Z. Aldrin Dalipi.

Të shoqëruar nga punonjësit e trashëgimisë kulturore në Bashkinë e Tiranës, nxënësit dëgjuan me vëmendje historinë e Tyrbes së Kapllan Pashës, ndërtuar në fillim të shekullit XIX dhe më pas u njohën me historinë e Kullës së Sahatit.

Nxënësit vizituan edhe ambientet e brendshme të Bashkisë së Tiranës, ku u pritën nga Z. Aldrin Dalipi dhe Nënkryetari i Bashkisë së Tiranës Z. Abaz Hado, i cili u foli nxënësve për punimet që po bëheshin në Sheshin Skënderbej.



EKSKURSION NË VALBONË

Klubi i Kinemasë kaloi një fundjavë të këndshme në Valbonë. Udhëtimi filloi ditën e shtunë. Mbas një ndalese në Perlë, nxënësit morën tragetin e Komanit dhe arritën në qytetin e Tropojës. Ata kaluan natën në Valbonë, ku bënë edhe ecje në natyrë. Ditën e dielë u nisën për në Kosovë, ku dhe vizituan qytetin historik të Prizrenit.

VIZITONJË BIZNESE



Nxënësit
ta në e dhe
biznese të ndryshme
duke përfituar njohuri
të vlefshme se si mund
të jesh i suksesshëm dhe
të bësh punën që dëshiron
njëkohësisht. Një ndër ta ishte
pastiçeri "Nela", ku nxënësit
vizituan së pari fabrikën e
më pas u shoqëruan për
te pastiçeria dhe te furra
e bukëve speciale. Vizita
shumë interesante dhe
argëtuese ishin edhe
ato në Fabrikën Ama
Cafe dhe në spitalin
Amerikan 3.



NË CINEPLEX



Nxënësit e ciklit fillor të shkollës sonë përjetuan me gëzim dhe emocione të veçanta aktivitetin e radhës në kinemanë Cineplex. Nxënësit e klasave I-III ndoqën me kënaqësi filmin “Sing”, të cilin e shoqëruan me këngë dhe duartrokitje, ndërsa nxënësit e klasave IV-V panë filmin “Moana”, i cili i bëri për vete me pamjet e mrekullueshme dhe mesazhin e dobishëm që përçoi te fëmijët. Nxënësit, të mahnitur pas pamjeve tredimensionale dhe realizimit mjaft të arrirë të filmave, i vazhduan komentet për ta edhe pas kthimit në shkollë.

VIZITË NË NEWS24



Televizioni News24 hapi dyert për disa vizitorë mjaft të veçantë, nxënësit e klasës 5G. Aty u pritën dhe u shoqëruan nga drejtori i këtij televizioni Z. Andi Tela, dhe për t’u folur fëmijëve erdhi edhe drejtoresha e informacionit, Znj. Anduena Manushi. Ata ndoqën udhërrëfimin nëpër studiot e regjistrimit të lajmeve, në studion e emisionit Vila 24 dhe në studion ku zhvillohen emisionet Studio e Hapur, FairPlay, Me zemër të Hapur, Të bësh ekonomi etj. Në fund ata u ndalën në studiot e Radio Rash dhe regjistruan zërat e tyre në leximin e lajmeve.

FESTA E ABETARES



Pas mësimi të leximit dhe të shkrimit të gjuhës sonë të bukur shqipe, përfundimi i librit të parë për çdo fëmijë mbart një emocion dhe kujtim të veçantë siç është Festa e Abetares. Kjo traditë e bukur që zhvillohet kudo në Shqipëri, u zhvillua edhe në shkollën tonë me mjaft entuziazëm. Këngët e bukura për shkronjat dhe festën, vargjet e recituara me emocion, kërcimet ritmike dhe veshjet e bardha të fëmijëve e mbushën skenën dhe sallën me një atmosferë të gëzueshme dhe mjaft pranverore. Emocionet ndiheshin te zërat e fëmijëve dhe në sytë e prindërve që i ndiqnin me vëmendje nga radhët e spektatorëve. Duartrokitjet, buzëqeshjet dhe falenderimet në fund të festës ishin treguesi më i mirë i suksesit të saj.

8 MARS

Dita Ndërkombëtare e Gruas pati vëmendjen saj të veçantë në një koncert festiv të organizuara në shkollën tonë.

Recitimet e vargjeve të poetëve më të njohur shqiptarë e të huaj si dhe loja në role e fëmijëve përcollën shumë emocione të ftuarit në koncert. Mbresëlënëse ishin këngëtares, të cilat kënduan drejtpërdrejt në skenë dhe në plate pranë nënave të tyre, si dhe kërcimet ritmike të cilat binin në sy për lëvizjet e sinkronizuara dhe për kostumet plot ngjyra e jetë.



FESTË VETËM PËR MËSUESIT

7 Marsi, Dita e Mësuesit, ashtu si çdo vit kaloi në një atmosferë festive mbushur me urime, buzëqeshje dhe aktivitete të larmishme. Për të nderuar dhe respektuar mësuesit, të cilët meritojnë vëmendje për punën e tyre të palodhur dhe plot pasion, drejtorja e shkollës kishte organizuar pas mësimit një aktivitet enkas për ta. Përveç kokteilit të shtruar për këtë rast, vend të rëndësishëm zunë këngët e njohura kushtuar mësuesve, pjesët orkestrale të interpretuara mjeshtërisht nga mësuesit e muzikës, vallet popullore si dhe dhuratat simbolike për çdo anëtar të stafit pedagogjik të shkollës.

VIZITË NË BUNKART

Nxënësit e klasave të 7A dhe 7H ishin pjesë e vizitës në BUNKART. Ky muze, me sende e pamje nga periudha e diktaturës komuniste, ngjalli kureshtjen e tyre. Teksa hynin e dilnin nga dhomat e vogla, dallohej habia e nxënësve në lidhje me ndodhitë dhe mjetet e ndryshme të periudhës, të cilën e kanë kthyer në temën e bunkerit.



SHËTITJE NË DAJT

Nxënësit e klasës 5B kaluan një ditë mjaft argëtuese në natyrën e bukur dhe me ajër të pastër që të ofron mali i Dajtit në stinën e pranverës. Gjatë udhëtimit me teleferik fëmijët soditën me kënaqësi pamjet e mrekullueshme që ofron ky Park Kombëtar. Pas mbërritjes në mal, fëmijët bënë shëtitje me kuaj, luajtën lojëra të ndryshme në hapësirat e gjelbra dhe shijuan një drekë të veçantë në natyrë. I gjithë aktiviteti u sponsorizua nga menaxherja e "Dajti Ekspres", znj. Migena Malo Storey, e cila është njëkohësisht prind i kësaj klase.



NDESHJA E FUTBOLLIT ME SHKOLLËN “MIST”



Loja e futbollit mes klasave të 7-ta të shkollave “Turgut Özal” dhe “MIST” u luajt nga ekipe me nxënës të përzgjedhur nga i gjithë paraleli.

Ndeshja u zhvillua në ambientet sportive të shkollës sonë, në dy pjesë me nga 20 minuta secila. Atmosfera ishte mjaft e ndezur për shkak të tifozerisë së shumtë. Të gjithë nxënësit u aktivizuan gjatë kësaj loje që u finalizua më pas me fitoren e shkollës “Turgut Özal”.

KAMPIONATI I FUTBOLLIT

Një nga aktivitetet sportive të zhvilluara gjatë muajit shkurt ishte Kampionati i Futbollit midis djemve të klasave të 8-ta. Ky kampionat u zhvillua në ambientet e palestrës së shkollës. Në finale dolën klasat 8C dhe 8D. Kupa shkoi te klasa 8D, pas një ndeshjeje të fortë e plot entuziazëm.



KAMPIONATI I FUTBOLLIT - KLASAT 4, 5



fushë. Ndeshjet e mëpasshme vazhduan sipas sistemit të eliminimit. Në çdo ndeshje ra në sy forma e mirë fizike e lojtarëve dhe dëshira e madhe për të fituar. Përgëzojmë të gjithë nxënësit pjesëmarrës dhe në veçanti skuadrat fituese të secilit paralel.

Muaji maj pritej me shumë padurim nga djemtë e klasave të katërta dhe të pesta për shkak të një aktiviteti mjaft të dashur për ta siç është Kampionati i Futbollit. Ashtu si edhe në kampionatet e tjerë, edhe këtë herë sistemi i zhvillimit të ndeshjeve të para, ishte ai me short. Menjëherë pas hedhjes së tij skuadrat bënë përzgjedhjen e nxënësve përfaqësues dhe filluan lojën në

KAMPIONATI I HENDBOLLIT



Gjatë muajit shkurt u zhvillua kampionati i hendbollit për klasat e pesta dhe në të morën pjesë të gjitha vajzat e paralelit. Pas ndeshjeve çerekfinale të të gjitha klasave, arritën të kalojnë në gjysmëfinale klasat 5A, 5B, 5G, 5F. Në përfundim të ndeshjeve eliminatore dy skuadrat që arritën në finale ishin 5A dhe 5G. Fituese doli klasa 5G me rezultatin 10-2.

FINALET E BASKETBOLLIT

Të shumtë ishin ata që kanë ndjekur me ankth dy ndeshje finale të bukura basketbolli të klasave të gjashta. Klasat finaliste ishin 6A, 6F për vajzat dhe 6G, 6D për djemtë. Në ndeshjen mes vajzave nuk mungoi energjia dhe aktivizimi nga ana e të gjitha lojtareve. Rezultati përfundimtar ishte 12-18, ku epërsi pati e gjashta F. Tek djemtë loja ishte pak më e rreptë dhe konkurruese, duke mos lejuar krijimin e diferencës. Janë dashur minutat e fundit të lojës për të përcaktuar skuadrën fituese. Takimi u mbyll me rezultatin 7-9 për të gjashtën D.



KAMPIONATI I BASKETBOLLIT - KLASAT 4, 5



Muaji maj solli për klasat e katërta dhe të pesta edhe një aktivitet tjetër sportiv mjaft të bukur, siç ishte Kampionati i Basketbollit. Ishte hera e parë që ky kampionat zhvillohej për këtë grupmoshë dhe interesimi i djemve ishte shumë i madh. Në fillim u hodh shorti për ndeshjet e para mes klasave dhe më pas u vazhdua me sistem eliminimi. Morën pjesë të gjitha klasat e katërta dhe të pesta, por kupa u takoi vetëm dy skuadrave më të mira për secilin paralel.

DITA E BALONAVE

Grupet e 3-ta të kopshtit “Zübeyde Hanım” shfrytëzuan hapësirat e gjelbra të Kopshtit Botanik për të bërë ngritjen e shumëpritur të balonave.

Disa fëmijë i kishin përgatitur ato në shtëpi me ndihmën e prindërve, ndërsa disa të tjerë zgjodhën të blinin balona me personazhin e tyre të preferuar.

Kjo është një nga festat e parapëlqyera të fëmijëve dhe gjithashtu një mundësi më tepër për t’u socializuar e për të marrë ajër të pastër në natyrë.



SHËTITJE NË KOPSHTIN BOTANIK

Pjesë e orëve mësimore të fëmijëve të grupeve të para e të dyta janë edhe njohuritë mbi diturinë e natyrës. Kësaj here ata e zhvilluan mësimin tek Kopshti Botanik.

Vogëlushët dukeshin të lumturuar e të mahnitur njëkohësisht nga larmishmëria e luleve me aromë të tyre të këndshme dhe pemët e larta që rriten në këtë kopsht.

Pas shëtitjes ata u fotografuan në sfondin e mrekullueshëm shumëngjyrësh që ky kopsht di të ofrojë.



MBJELLJA E LULEVE DHE KUJDESI PËR TO

Fëmijët e grupeve të para, të dyta dhe të treta të kopshtit "Zübejde Hanım" mund të quhen me plot gojën kopshtarë të vegjël. Në fillim të pranverës, atëherë kur bimët kanë stinën e tyre të lulëzimit, këta fëmijë u përkushtohen me shumë zell e dëshirë mbjelljes së luleve.

Jo vetëm kaq, por nuk harrojnë që çdo ditë t'i ujitin e të kujdesen për to duke hequr barishtet që pengojnë rritjen e tyre të shëndetshme.

Tashmë në oborrin e kopshtit tonë, ngado të hedhësh shikimin, mund të shohësh vazo të mëdha e të vogla me lule të të gjitha llojeve e ngjyrave, të mbjella nga duart e njoma të këtyre fëmijëve.



NË PULARI

Fëmijët e grupit të tretë të Delfinëve vizituan pularinë "Rea's" në qytetin e Durrësit. Atje ata morën mjaft njohuri të dobishme mbi këtë produkt ushqimor kaq të rëndësishëm për trupin e tyre siç është veza.

Momentet më interesante ishin kur panë nga afër kapanonet ku rriten pulat dhe procesin e paketimit të vezëve.



PËRGATITIM GURABIJE

Edhe pse ende shumë të vegjël, fëmijët e grupeve të para po mësojnë të gatujnë si të ishin shefa të vërtetë kuzhine. Pasi sollën përbërësit nga shtëpia, së bashku me edukatoren, ata përveshën mëngët dhe iu futën punës për përgatitjen e gurabijeve. Nuk mund të fshihej dot entuziazmi gjatë përgatitjes së brumit dhe fantazia femënore për t'u dhënë gurabijeve format që dëshironin. Në fund të një dite të lodhshme pune prindërit mund të shijonin një ëmbëlsirë të gatuar nga vetë fëmijët e tyre.



SHËTITJE TEK KOPSHTI ZOOLOGJIK

Drejtuesit e kopshtit organizuan një varg shëtitjesh për të gjitha grupet tek Kopshti Zoologjik. Në fillim fëmijët vizituan "shtëpitë" e kafshëve. Për shumë nga fëmijët kurioziteti nuk mund të fshihej sepse ishte hera e parë që shihnin nga afër kafshë dhe shpendë të tillë, si: ariu, ujku, dreri, struci, shqiponja etj. Pak më vonë, shëtitja i la vendin një pikniku me ushqime të shpejta, fotografive dhe kurorave me luledele.



8 MARS NË KOPSHT

Festa e 8 Marsit pritet me padurim edhe nga fëmijët e parashkollorit, të cilët për këtë ditë përgatitin punime artistike me duart e tyre të vogla dhe programe artistike të cilat i shfaqin në skenë. Çdo grup, nën udhëheqjen e edukatoreve të papërtuara, përgatiti një shfaqje të veçantë me numra të ndryshëm dhe të larmishëm të interpretuar plot ndjenjë nga fëmijët. Vargjet kushtuar nënave të tyre, këngët e dashura, zërat e tyre të ëmbël dhe kërcimet ritmike i bënë këto programe mjaft të bukura dhe emocionuese për nënat e vogëlushëve.



KËSHILLA NGA PRINDËRIT

Një mënyrë e mirë për të edukuar që në vogëli vlerat e të pasurit një profesion është edhe njohja në praktikë e fëmijëve me metodat e të punuarit të të rriturve.

Dhe aq më mirë nëse këta të rritur janë prindërit e tyre. Të ftuarit e radhës nga prindërit e grupeve të 2-ta ishin në profesionin e dentistes dhe të inxhinierit ushqimor. Kështu, fëmijët mësuhan se si duhet të kujdesen për higjienën orale dhe sa shpesh duhet bërë kontrolli i dhëmbëve. Gjithashtu një tjetër prind u shpjegoi atyre rëndësinë e respektimit të vakteve dhe i këshilloi për shmangien e disa ushqimeve që konsiderohen si jo të shëndetshme.




NË CIRK

Argëtimi është pjesë e pandarë e aktiviteteve që zhvillohen përgjatë vitit mësimor sidomos për fëmijët e kopshtit. Këtë herë ata ishin publiku më i zjarrtë i Cirkut Kombëtar në Tiranë. Mes akrobacive, ato që u pëlqyen më tepër ishin rrotullimet me rrathë, ngjitjet lart me litar, lojërat me ariun, numri me qenin që merrte kapelet etj.



KLUBI I ROBOTIKĒS




Rezervoni pushimet në 1 nga 10 resortet më të mira në botë

MAXX ROYAL

ekskluzivisht me Globus Travel



GLOBUSTRAVEL
Say Globus Think Travel



Rr. Mine Peza, ish-kafe Flora
Tel. + 355 6720 81333 / 6720 89333

E-mail: tourism@globustravel.al
www.globustravel.al